



URDHËR
Nr. 90, datë 2.4.2019

PËR DELEGIM TË PËRKOHSHËM KOMPETENCASH

Në mbështetje të neneve 12, pika 1, dhe 13, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, neneve 28, 29, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe nenit 7, pika 3 e rregullores “Për veprimtarinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelit të Gjykatës Kushtetuese”, e ndryshuar, në mungesë të kryetarit të Kolegjit,

URDHËROJ:

1. Delegimin e plotë të kompetencave të kryetarit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, gjyqtarit më të vjetër në moshë, z. Luan Daci, si vijon:
 - a) përgatit, thërret e drejton mbledhjen e anëtarëve;
 - b) përfaqëson Kolegjin e Posaçëm të Apelit në marrëdhënie me të tretët;
 - c) ndërmerret të gjitha masat e nevojshme dhe të përshtatshme për të siguruar funksionimin efektiv dhe efikas të Kolegjit;
 - d) nënshkruan aktet e tjera të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, me përjashtim të vendimeve;
 - e) drejton shortin në rastet e përcaktuara në nenet 14, 15, 18, pika 4, të ligjit nr. 84/2016.
2. Delegimi i kompetencave të mësipërme është për periudhën 4 prill 2019 deri më 11 prill 2019.
3. Për ndjekjen e këtij urdhri ngarkohet gjyqtari më i vjetër në moshë, z. Luan Daci.
4. Z. Luan Daci nuk mund t'i nëndelegojë këto kompetenca.
5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen të gjithë punonjësit e Kolegjit të Posaçëm të Apelit.
6. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Natasha Mulaj



